



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
01Nr.16-53248Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 21.06.2013
Nr. 0203-787

PËR: Qemajl Mustafa, Kryetar i Komunës së Gjilanit
Izmi Zeka, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES TË KOMUNËS SË GJILANIT, 01 Nr. 16-53246, Pranuar me datë, 17.06.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Rregullores 01 Nr. 16-53246 të miratuar me datë 13.06.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Rregullorja 01 Nr. 16-53246, e Punës së Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 21.06.2013

Br. 0204-787

Za: Qemajl Mustafa, Gradonačelnik Opštine Gnjilane
Ismi Zeka, Predsedavajući Skupštine Opštine Gnjilane

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE
GNJILANE, 01 Br. 16 - 53246 Primjeno dana, 17.06.2013

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-04, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva posle razmatranja Uredbe 01Br.16-53246, usvojene dana 13-06-.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni akt naveden u nastavku, ima puni pravni efekat .

- Uredba 01 br.16-53246, Rada Skupštine Opštine Gnjilane .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E GJILANIT - GJILAN BELEDIVESI
01 No. i aktit 016-53246
Data e detyrimit 03-06-2013
GJILAN - GJILANE - GILAN



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gjiçane
Municipality of Gjiçan
Gilan Belediyesi

**RREGULLORJA
PËR
PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT**

Gjiçan, prill 2013

Në bazë të nenit 12.2 pika b), 12.4 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008) dhe nenit 39 paragrafi 1.2 dhe nenit 48 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 të dt. 11.11.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më datën 13.06.2013, miraton:

R R E G U L L O R E N E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT

Neni 1

Dispozitat themelore

Lënda e rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohet puna dhe mënyra e funksionimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi).

Përkufizimet

Neni 2

1. Termet që përdoren për nevoja të kësaj rregulloreje kanë domethënie si vijon:

- 1.1. "Sekretaria e Kuvendit" nënkupton sektorin përkatës që ofron shërbime për Kuvendin e Komunës dhe trupave të tij.
- 1.2. "Fjalë jo kuvendare" nënkuptojnë fjalët të cilat përdoren në seancat e Kuvendit të Komunës ose në trupat punuese të tij që nxisin dhunën (ofendim, provokim, kërcënim etj);
- 1.3. "Çështje urgjente" nënkupton një çështje të paparashikuar dhe si e tillë nuk mund të pres që të parashtrohet në Kuvend sipas procedurës së rregullt për diskutim dhe vendosje në Kuvend;
- 1.4. "Projekt-rregullore" është një propozim për rregullore, i cili, përmes drejtorisë, komitetit përkatës dhe ekzekutivit i është dorëzuar kuvendit për debat dhe votim;
- 1.5. "Grup i anëtarëve" nënkupton një grup të përbërë nga anëtarët e një partie, koalicioni ose iniciative qytetare, nga një numër i caktuar i anëtarëve të kuvendit të komunës që kanë së paku tre (3) anëtar, sipas përkufizimit në këtë rregullore, të cilët e kanë njoftuar me shkrim kryesuesin e kuvendit të komunës për marrëveshjen e tyre që të veprojnë si grup i anëtarëve;
- 1.6. "Javë pune" nënkupton javën e punës në të cilën kuvendi mbanë mbledhje të rregullt, përveç javës Kuvendi mbledhet si pasojë e shqyrtimit të çështjeve të ngutshme edhe në ditët jo të punës;
- 1.7. "Ditë pune" nënkupton një ditë jave, nga e hëna deri të premten, përfshirë edhe këto të dyja, duke i përjashtuar festat publike, gjatë javës në të cilën kuvendi do të takohet normalisht.

Mbledhja Inauguruese

Neni 3

Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës do të procedohet në pajtim me neni 42 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe sipas neni 50 të Statutit të Komunës së Gjilanit.

Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Kuvendit

Neni 4

- 1) Kuvendi, në mbledhjen e tij të parë inauguruese e themelon Komisionin e Përkohshëm për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit, para nënshkrimit të mandatit nga secili anëtarë.
- 2) Komisioni themelohet me shumicë të votave të anëtarëve që janë të pranishëm në seancë i cili përbëhet nga anëtarë të Kuvendit dhe pasqyron, përbërjen politike të Kuvendit.
- 3) Komisioni i paraqet Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të anëtarëve të Kuvendit.

Betimi

Neni 5

1. Betimi i kryetarit të Komunës së Gjilanit, procedohet në pajtim me neni 57 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe sipas neni 77 të Statutit të Komunës së Gjilanit.
2. Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës, procedohet në pajtim me paragrafin 4 të neni 35 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas paragrafit 2 neni 51 të Statutit të Komunës së Gjilanit.

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit

Neni 6

Zgjedhja e kryesuesit dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, procedohen në pajtim me nenin 42 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, neni 52 të Statutit të Komunës së Gjilanit dhe udhëzimit administrativ të MAPL-së nr. 2009/01.

Neni 7

Kryesuesi i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë së kuvendit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe Rregulloren e Kuvendit.

Neni 8

Mbledhjet e Kuvendit thirren dhe kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit ose në mungesë të tij nga zëvendëskryesuesi i Kuvendit.

Përgjegjësitë e Kuvendit

Neni 9

1. Kuvendi i komunës në pajtim me LVL-në, akteve nënligjore dhe Statutin e Komunës, ka përgjegjësitë e veta për marrjen e vendimeve si në vijim:
 - 1.1. statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
 - 1.2. miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
 - 1.3. miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
 - 1.4. planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
 - 1.5. themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji;
 - 1.6. emërimin dhe shkarkimin e nënkryetarit për komunitete;
 - 1.7. zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës;
 - 1.8. nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
 - 1.9. krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
 - 1.10. emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
 - 1.11. arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
 - 1.12. marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
 - 1.13. përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

Kushtet e punës për anëtarë dhe trupa punuese të Kuvendit

Neni 10

Anëtarëve të Kuvendit, trupave punuese të tij dhe në veçanti grupeve më të mëdha politike, u sigurohet mjedis i punës dhe pajisje të nevojshme për punë.

Plani dhe kalendar i punës së Kuvendit

Neni 11

1. Nën udhëheqjen e kryesuesit, Kuvendi i Komunës themelon grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.
2. Grupi punues, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton draftin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik.
3. Para përfundimit të vitit aktual kalendarik, Kuvendi miraton planin e punës të Kuvendit të Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik.
4. Në seancën e parë të vitit kalendarik, Kryesuesi i paraqet Kuvendit të Komunës raport mbi realizimin e Planit të punës për vitin paraprak kalendarik.
5. Plani i punës mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e kuvendit.

6. Plani i punës i Kuvendit të Komunës publikohet në faqen elektronike të Komunës në gjuhët zyrtare të Komunës.
7. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, organizon takime periodike me përfaqësues të OJQ-ve dhe mediave lokale me qëllim të vlerësimit dhe plotësimit të Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.
8. Kuvendi çështjet që janë në kompetencë të kryetarit të Komunës, i shqyrton edhe pa qenë të përfshira në planin e punës.
9. Plan vjetor i punës së Kuvendit përmban:
 - 9.1. objektivat e Kuvendit;
 - 9.2. qëllimet e Kuvendit;
 - 9.3. aktivitetet e planifikuara të Kuvendit;
 - 9.4. aktivitetet e planifikuara të komiteteve obligative dhe funksionale;
 - 9.5. aktivitetet e planifikuara të Grupit të Grave dhe grupeve tjera joformale të Kuvendit;
 - 9.6. afatet për përmbushjen dhe realizimin e aktivitetëve të parapara;
 - 9.7. koston financiare për implementimin e planit të punës.

Neni 12

1. Për zbatimin e planit të punës së Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit i propozon Kuvendit kalendarin e mbledhjeve të Kuvendit. Kalendar i mbledhjeve të Kuvendit nuk mund të ketë më pak mbledhje se sa janë të përcaktuara me ligj.
2. Projekt-kalendar i mbledhjeve u jepet kryetarëve të grupeve të përfaqësuar në kuvend dhe anëtarëve të Këshillit të drejtorëve dhe kryetarit të Komunës të paktën 7 ditë para zhvillimit të mbledhjes.
3. Kalendar i mbledhjeve përmban në mënyrë të detajuar kohën kur Kuvendi zhvillon punimet në mbledhje. Kalendar i mbledhjeve mund të ndryshohet nga ana e Kuvendit.
4. Kalendar publikohet dhe u shpërndahet anëtarëve të Kuvendit, si dhe u vihet në dispozicion përfaqësuesve të mediave. Në çdo rast, rendi i ditës duhet të jetë bërë publik sipas statutit të Komunës dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.

Mbikëqyrja e punës së Administratës së Komunës nga ana e Kuvendit të Komunës

Neni 13

1. Kuvendi i Komunës çdo gjashtë (6) muaj, shqyrton raportin e kryetarit mbi gjendjen ekonomike-financiare të Komunës.
2. Kuvendi i Komunës çdo tre (3) muaj, shqyrton raportin tre mujor financiar për periudhën përkatëse.
3. Kryetari i Komunës ose drejtori përgjegjës për implementimin e një rregulloreje komunale, është i obliguar që së paku një herë në vit, t'i paraqesë raport Kuvendit të Komunës mbi ecurinë e implementimit të rregullores përkatëse.

4. Afatet për shqyrtimin e dokumenteve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, parashihihen në planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.

Publiciteti i mbledhjeve

Neni 14

1. Mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura, me përjashtim të rastit kur Kuvendi vendos ndryshe.
2. Kërkesën me shkrim për të zhvilluar mbledhje të mbyllur të Kuvendit, mund ta bëjnë më së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit, apo me kërkesën e kryetarit.
3. Kërkesa për mbledhje të mbyllur të Kuvendit, mund të miratohet vetëm për rastet siç është përcaktuar me ligj.
4. Kur vendoset zhvillimi i mbledhjes së mbyllur të kuvendit, kryesuesi i mbledhjes u kërkon personave të ftuar, mediave dhe personave nga publiku, të largohen nga salla. Në raste të tilla, Kuvendi njofton për vendimin e marrë. Nuk mund të zhvillohen mbledhje të mbyllura gjatë shqyrtimit të buxhetit të komunës ose projekt-akteve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Neni 15

Në pamundësi për transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve, incizimi i mbledhjeve të vendoset në veb faqen elektronike të komunës.

Fillimi i mbledhjes

Neni 16

1. Kryesuesi i Kuvendit ose zëvendëskryesuesi i autorizuar prej tij e hap, drejton dhe mbyll mbledhjen e Kuvendit.
2. Mbledhja fillon me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme. Kur nuk ka vërejtje për tekstin, ai quhet i miratuar dhe, nëse kërkohet, ai votohet me ngritjen e dorës. Për procesverbalin fjala u jepet vetëm anëtarëve që kërkojnë të propozojnë korrigjim ose të saktësojnë mendimin e tyre të shprehur në mbledhjen parazardhëse për jo më shumë se 2 minuta.

Çështje që s'janë në rendin e punës

Neni 17

Para fillimit të rendit të ditës, çdo anëtar mund të diskutojë për çështje të ndryshme që ai i konsideron se duhen bërë publike në mbledhje. Në këtë rast, anëtari nuk mund të flasë më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit që i përket, jo më shumë se 10 minuta. Kryesuesi i mbledhjes kujdeset të harmonizojë diskutimet e çdo anëtari, sipas përkatësisë në grupin përkatës. Koha e përgjithshme për diskutimin e këtyre çështjeve nuk mund të jetë më shumë se 30 minuta. Në rast se, me diskutime kalohet kjo kohë, kryesuesi i Kuvendit ndërpret

diskutimet e anëtarëve dhe atyre që kanë ngelur pa diskutuar u jepet fjala në fillimin e mbledhjes pasardhëse.

Diskutimet në mbledhje

Neni 18

1. Kryetari, të emëruarit e tij, zyrtarët dhe personat tjerë të autorizuar që nuk janë anëtarët të Kuvendit, por që janë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit, do të lejohen nga ana e Kryesuesit të Kuvendit, të diskutojnë dhe t'i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre nëse kjo paraqitet si nevojë për të dhënë kontribut në mbledhje.
2. Diskutimet fillojnë pasi kryesuesi i mbledhjes njofton hapjen e tyre. Asnjë anëtarë i Kuvendit, nuk mund të diskutojë pa iu dhënë fjala nga kryesuesi i mbledhjes. Fjala kërkohet me ngritjen e dorës.
3. Po ashtu radhitja në ulëse të kuvendit bëhet duke filluar nga kryesuesit e grupeve politike, për secilin grup politik

Parashtrimi i pyetjeve për kryetarin e Komunës, drejtorë dhe zyrtarë tjerë

Neni 19

1. Anëtarët e Kuvendit, kanë të drejtë të parashtrojnë pyetje lidhur me punën dhe përgjegjësitë e kryetarit të Komunës, drejtorëve dhe për zyrtarë të tjerë. Përgjigjet në pyetjet e tyre ata, mund të paraqesin menjëherë në mbledhje ose me shkrim në mbledhjen vijuese të Kuvendit. Për pyetjet, përgjigjet e paraqitura aty për aty, menjëherë do të përfshihen në rendin e punës së mbledhjes.
2. Pyetjet e parashtruara sipas paragrafit 1 të këtij neni, marrin përgjigje sipas rendit të parashtrimit të tyre. Kryesuesi i Kuvendit do të lejojë anëtarin, që pas përgjigjes së dhënë, të bëjë menjëherë edhe pyetje shtesë.
3. Nëse një pyetje e parashtruar refuzohet, anëtarit që e ka parashtruar pyetjen duhet t'i jepet një shpjegim me shkrim deri në mbledhjen vijuese të kuvendit.
4. Për kërkesat për të cilat anëtarët apo grupet politike njoftojnë Kuvendin se do t'i bëjnë me shkrim, duhet të marrin përgjigje në afatin prej 30 ditësh, në të kundërtën çështja do të shtrohet në Kuvend për diskutim në mbledhjen e radhës.

Koha e diskutimeve

Neni 20

1. Çdo diskutues, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore parashikohet ndryshe, ka të drejtë të flasë jo më shumë se shtatë (7) minuta. Diskutuesi nuk mund të flasë më shumë se një herë për thelbin e së njëjtës çështje dhe nuk mund të marrë nga koha e një diskutuesi tjetër.

2. Diskutimi në emër të grupit kuvendar dhe në emër të propozuesit të projekt-aktit, mund të zgjatë më së tepërmi pesëmbëdhjetë (15) minuta.
3. Koha e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të zgjatet kur diskutohet Projekt-statuti i Komunës, i cili miratohet dhe ndryshohet më së paku, me votim të dy të tretës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, rregullorja e punës së kuvendit, që miratohet dhe ndryshohet, me votimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe për çdo çështje tjetër me interes publik, që është propozuar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Radha e diskutimeve

Neni 21

1. Shqyrtimi i një projekt-aktit bëhet në pajtim me rendin e mëposhtëm:

- 1.1. propozuesi i projekt-aktit do të flasë i pari.
- 1.2. në rast se propozuesi nuk është drejtor i drejtorisë, drejtori i drejtorisë do të ketë të drejtën të flasë i dyti.
- 1.3. kryetari i komitetit funksional, apo kryetari i komisionit do të ketë të drejtën e radhës.
- 1.4. kryetarët e grupeve përkatëse politike sipas fuqisë politike në Kuvend do të kenë të drejtën, të flasin pasi të kenë fol kryetarët e komiteve apo komisioneve.
- 1.5. kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Kuvendit do të kenë të drejtë të flasin në çdo kohë pasi të ketë fol propozuesi dhe pasi të kenë përfunduar çdo paraqitje e ekzekutivit,
- 1.6. të gjithë anëtarët e kuvendit, kanë të drejtë të diskutojnë në lidhje me projekt-aktin, sipas rendit të caktuar nga kryesuesi i Kuvendit.
- 1.7. në fund të diskutimeve, propozuesi i projekt-aktit, ka të drejtë të përgjigjet dhe pastaj kryesuesi i Kuvendit i mbyll diskutimet.

Replika

Neni 22

Anëtari i kuvendit, apo çdo diskutues tjetër, ka të drejtën e replikës, kur ndaj tij janë shprehur fjalë të padenja apo të pahijshme, ose janë bërë diskutime që kanë shtrembëruar thelbin e fjalës së tij. Replika bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 2 minuta. Për të njëjtin diskutim anëtari nuk mund të bëjë më shumë se një replikë. Anëtari, si dhe anëtarë të tjerë, nuk lejohen të bëjnë replikë ndaj replikës.

Çështje të procedurës

Neni 23

1. Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores së punës, kërkesat që përmbajnë propozime për ndryshime ose plotësime të rendit të ditës të miratuar, kërkesat për ndërprerjen ose

shtyrjen e mbledhjes ose të diskutimeve, kërkesat për të sfiduar nëse janë shkelur të drejtat e një anëtar, të përcaktuara me këtë Rregullore si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit.

2. Ndërhyrjet për çështjet e procedurës bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes kryesore.
3. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 3 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë edhe anëtarët *pro* dhe *kundër*, jo më shumë se 3 minuta secili dhe merret vendim me votim të hapur nga Kuvendi me ngritjen e dorës.
4. Për të gjitha kërkesat procedurale zhvillohet debat në Kuvend, përpos për kërkesën për të shtyrë mbledhjen e Kuvendit dhe diskutimin për ndonjë pikë të rendit të ditës për të cilat nuk ka nevojë të zhvillohet debat, por mbahet votimi i menjëhershëm.
5. Lidhur me kërkesën për të sfiduar nëse janë shkelur të drejtat e një anëtar, të përcaktuara me këtë Rregullore, kryesuesi i Kuvendit, shqyrton kërkesën dhe brenda mbledhjes ose në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, i raporton Kuvendit se a janë shkelur të drejtat e anëtarit. Nëse janë shkelur të drejtat e anëtarit të Kuvendit, kryesuesi do të sugjeroi anëtarin e Kuvendit që të korrigjoj veprimet e tija në të ardhmen.

Sqarimi i votës kundër

Neni 24

Anëtar ka të drejtën e sqarimit të arsyeve të votimit "kundër" deri në 3 minuta. Kur kërkohet të bëhet sqarim për votimin kundër, atij i jepet fjala menjëherë pas votimit.

Ndërprerja dhe shtyrja e mbledhjes

Neni 25

1. Kryesuesi i mbledhjes, kur çmohet prej tij ose me kërkesën e një grupi përkatës në kuvend mund ta ndërpresë mbledhjen por jo më shumë se 30 minuta.
2. Rastet për të cilat mund të ndërpritet mbledhja e kuvendit mund të jenë:
 - 2.1. kur pushimi gjatë mbledhjes (pauza) zgjatë më shumë se 30 minuta,
 - 2.2. kur gjatë mbledhjes numri i anëtarëve bie nën numrin e paraparë për mbajtjen e mbledhjes dhe vendosje meritore të paraparë me këtë rregullore,
 - 2.3. kur për shkak të qëndrimit të gjatë në mbledhje, e njëjta nuk mund të kryhet atë ditë dhe
 - 2.4. kur vjen gjerë te prishja e rëndë e rendit të punës, por që kryesuesi nuk është në gjendje që me masa disiplinore të parapara me këtë rregullore, ta kthejë në gjendje normale punë mbledhjen e kuvendit.
3. Mbledhja e caktuar e kuvendit shtyhet kur paraqiten shkaqet të cilat e pamundësojnë mbajtjen e saj, në ditën e caktuar dhe kur pas hapjes konstatohet se në mbledhje nuk marrin pjesë një numër i mjaftueshëm i anëtarëve të Kuvendit, për vendosje meritore.
4. Për shtyrjen e mbledhjes së Kuvendit vendos kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit.

Rregulli dhe sjellja në mbledhje të kuvendit

Neni 26

1. Anëtarët, nuk duhet të ndërpresin fjalën e kryesuesit të mbledhjes ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe jo adekuate në mbledhje të Kuvendit, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë anëtarë, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo anëtarë, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset e Kuvendit.
2. Kryesuesi, mund të caktojë rregulla, përkitazi me pjesëmarrjen dhe sjelljen e publikut dhe të përfaqësuesve të mediave që ndjekin mbledhjet e kuvendit.
3. Kryesuesi i Kuvendit, kërkon nga të gjithë personat që nuk i respektojnë rregullat e tilla, të largohen nga mbledhja e Kuvendit.

Masat disiplinore

Neni 27

1. Masat disiplinore që zbatohen ndaj anëtarëve janë:
 - 1.1. tërheqje vëmendjeje;
 - 1.2. vërejtje;
 - 1.3. marrja e fjalës
 - 1.4. përjashtim nga mbledhja e Kuvendit;
 - 1.5. përjashtim nga pjesëmarrja në tri (3) mbledhje të komiteteve, komisioneve dhe në mbledhje të Kuvendit.

Masa disiplinore e tërheqjes së vëmendjes dhe vërejtjes

Neni 28

1. Kur anëtarë thotë fjalë jo kuvendare, pengon me sjelljen e tij punën e mbledhjes së Kuvendit ose cenon rregullat e saj, i tërhiqet vëmendja nga kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit.
2. Në rast se anëtarë, ndaj të cilit është zbatuar masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, kërkon të japë shpjegime për veprimet e tij, fjala i jepet në përfundim të mbledhjes së Kuvendit të asaj dite për jo më shumë se 2 minuta.
3. Kur anëtarë e përsërit veprimin në të njëjtën mbledhje të Kuvendit, pasi i është tërhequr një herë më parë vëmendja, ose anëtarë që cenon seriozisht rendin në mbledhje të Kuvendit, i jepet vërejtje nga kryesuesi i mbledhjes. Vërejtja regjistrohet në procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së Kuvendit të Komunës dhe bëhet publike.
4. Nëse anëtarë pas shqiptimit të vërejtjes vazhdon me sjelljet e tija apo me fjalim që nuk është në përputhje me rendin e ditës, i merret fjala.
5. Në rast se shprehjet ose fyerjet e bëra nga anëtarë në mbledhje të Kuvendit tërhiqen prej tij në po të njëjtën mbledhje dhe anëtarë kërkon publikisht ndjesë për sjelljen e tij, masa

disiplinore e dhënë në zbatim të paragrafit 3 të këtij neni, anulohet nga kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

Masat disiplinore më të rënda

Neni 29

1. Kur anëtari përdor fjalë ofenduese ose cenon personalitetin e kryesuesit të mbledhjes së Kuvendit, apo vazhdon të kryejë veprime, pasi më parë në të njëjtën mbledhje janë zbatuar masat disiplinore, sipas neni 27 të kësaj Rregulloreje, me urdhër të kryesuesit të mbledhjes, përjashtohet nga mbledhja e Kuvendit për atë ditë. Në rast se anëtari nuk pranon të dalë nga salla, kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit e ndërpret atë dhe i jep porositë e nevojshme shërbimit të sigurisë në Kuvend, për zbatimin e urdhrit të dhënë.
2. Masa disiplinore e përjashtimit nga mbledhja e Kuvendit, shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me një ditë nga kompensimi për marrje pjesë në mbledhje të Kuvendit të Komunës.
3. Kur anëtari bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në mbledhje të kuvendit që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon anëtarët e tjerë, drejtorët dhe zyrtarët tjerë ose përdor fjalë fyese për kryetarin e Komunës apo bartës të institucioneve të tjera të Komunës, ndalohej të marrë pjesë në punimet e Kuvendit dhe në komitetet e tij në mbledhjen e ardhshme.
4. Ndalimi i pjesëmarrjes vendoset nga kryesuesi i Kuvendit.
5. Masa disiplinore e ndalimit të pjesëmarrjes në mbledhje të Kuvendit dhe në komitete, shoqërohet me sanksion financiar të mbajtjes së kompensimit për anëtarin për atë mbledhje sa është marrë masa disiplinore.
6. Në rast se anëtari përpiqet të hyjë në sallën ku mbahet mbledhja e Kuvendit ose të komiteteve apo komisioneve përpara mbarimit të kësaj mase ndëshkimore, afati i masës dyfishohet.
7. Për ngjarje tepër të rënda që ndodhin jashtë sallës ku zhvillohen punimet e Kuvendit, por brenda mjediseve të tij, kryesuesi i Kuvendit të Komunës merr masën disiplinore të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni.
8. Masat e parapara me lartë në këtë rregullore nuk aludojnë në çfarëdo përkufizimi në të shprehurit e mendimit të lirë.

Përcaktimi i rendit të ditës

Neni 30

1. Në fund të çdo seance, kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës, ndonjë grup i anëtarëve ose ndonjëri nga anëtarët mund të propozojë ndonjë pikë për t'u diskutuar në mbledhjen e ardhshme të kuvendit, në rast se një gjë e tillë nuk kundërshtohet nga shumica e anëtarëve në mbledhje.
2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, paraprakisht konsultohet me kryetarin e Komunës, kryetarët e grupeve parlamentare, komitetin për politikë dhe financa, për caktimin e rendit të ditës të mbledhjeve të kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit, po ashtu konsultohet edhe për çështjet e orarit të ditës.

Mbledhjet e jashtëzakonshme

Neni 31

Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren dhe mbahen në pajtim me nenin 44 të LVL-së dhe nenin 57 të Statutit të Komunës së Gjilanit.

Çështjet urgjente

Neni 32

1. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, çdo grup përkatës politik ose anëtarë që paraprakisht e ka marrë lejen e kryesuesit të Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi, menjëherë të marrë parasysh një çështje urgjente me interes të veçantë publik, e cila është paraqitur në kohën midis dy mbledhjeve të Kuvendit. Nëse kryesuesi i Kuvendit konsideron se çështja meriton vëmendjen e menjëhershme të Kuvendit, ai do të lejojë grupin përkatës ose anëtarin në fjalë që të arsyetojë propozimin e tij në Kuvend dhe pastaj do të vë në votim atë çështje. Përfundimisht kur propozimi i bërë nuk është bërë nga kryetari ose emëruari i tij, atëherë kryetari ose të emëruarit të tij do t'i lejohet të paraqes pikëpamjet e veta para se të votohet. Nëse Kuvendi vendos të marrë parasysh çështjen, atëherë duhet ta bëjë një gjë të tillë gjatë takimit.
2. Rregullat lidhur me mbledhjet e jashtëzakonshme nuk zbatohen për takime që thirren për shkaqe të rrethanave urgjente.

Kuorumi dhe Votimi

Neni 33

1. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës është i vlefshëm, nëse gjysma e anëtarëve të Kuvendit janë të pranishëm në mbledhje, me të drejtë pjesëmarrje dhe votimi.
2. Mbledhjet e Kuvendit ndërpriten, nëse numri i anëtarëve të pranishëm në sallë bie nën një të dytën (1/2) e numrit të përgjithshëm.
3. Vendimet e Kuvendit të komunës merren me votimin të thjeshtë të shumicës së anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë "për" ose "kundër", përveç në rastet kur me këtë Rregullore të punës parashihet shprehimisht ndonjë kërkesë tjetër votimi.
4. Votimi bëhet përmes njërës prej mënyrave në vijim:

votimi i thjeshtë "për" – "kundër" – "abstenim" me ngritje dore, përmes votimit të regjistruar me thirrjen e secilit anëtar veç e veç ose votim elektronik.

votimi i regjistruar, bëhet në rast kur këtë e kërkon kryesuesi i kuvendit ose një grup përkatës. Në rastet kur mbahet votimi i regjistruar, vota e secilit anëtar "për", ose "kundër", do të regjistrohet me emër.

votimi elektronik, mund të zbatohet nëse ekzistojnë pajisjet e nevojshme elektronike.

5. Votim i fshehtë, i cili bëhet në fletëvotime të cilat duhet të jenë pa tjetër të madhësisë,

ngjyrës dhe formës së njëjtë. Votimi i fshehtë mund të vjen në shprehje vetëm për çështje të caktuara. Për votim të fshehtë Kuvendi i Komunës, vendos me vendim paraprak. Procedurën e votimit e cakton dhe zbaton kryesuesi i mbledhjes me anëtarët tjerë të kryesisë së punës së Kuvendit.

6. Në rast të numrit të barabartë të votave të hedhura "për" dhe "kundër" ndonjë propozimi, kryesuesi i Kuvendit e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave.

Nënshkrimi i akteve të miratuara nga Kuvendi

Neni 34

1. Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës nënshkruhen nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës. në mungesë të kryesuesit të Kuvendit të Komunës, aktet i nënshkruan personi i caktuar për kryerjen e funksionit të tij/saj.
2. Nënshkrimi i akteve të miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës duhet të bëhet, më së voni 7 ditë pas miratimit të tyre nga Kuvendi i Komunës.

Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Kuvendit komunal

Neni 35

1. Të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe mundësi për të marrë plotësisht pjesë në proceset e kuvendit pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare, racën, ngjyrën, gjininë, fenë, mendimin politik ose ndonjë dallim tjetër.
2. Çdo anëtarë i kuvendit detyrohet që të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit duke u përgatitur për mbledhje dhe duke parashtruar mendimin e vetë lidhur me çështjet që janë në rend të ditës. Po ashtu çdo anëtar duhet që gjithherë ta njoftojë kryesuesin e mbledhjes së Kuvendit për pamundësinë e ardhjes së tij në mbledhje dhe arsyet për mosardhjen e tij të konstatohen në procesverbal.
3. Kuvendi i Komunës do të tregojë transparencë për sugjerimet që vijnë nga përfaqësuesit e minoriteteve që jetojnë në Komunën e Gjilanit dhe me kujdes ato do t'i marrë në konsideratë.
4. Kuvendi i Komunës do t'ua lehtësojë pjesëmarrjen aktive të anëtarëve me aftësi të kufizuara dhe do të sigurojë çfarëdo ndihme teknike për këtë qëllim.
5. Kuvendi i Komunës do të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të anëtarëve femra dhe të sigurojë se zëri i tyre do të dëgjohet plotësisht duke e marrë parasysh para, gjatë dhe pas mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
6. Inkurajimi për pjesëmarrjen aktive në punën e Kuvendit Komunës dhe në sigurimin e të drejtave për minoritete, femra dhe për persona me aftësi të kufizuara, nuk do të konsiderohen si diskriminim i kundërt ndaj përfaqësuesve të shumicës.

Konflikti i Interesit

Neni 36

1. Në rast se gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të Kuvendit, anëtarit të komitetit apo komisionit, paraqitet gjendja e mospajtitimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private, do të zbatohet neni 38 i LVL-së, dispozitat përkatëse të Statutit të Komunës dhe dispozitat e ligjit në fuqi.
2. Në rast se ekziston konflikti i interesit dhe gjatë procedurës vendim – marrjes, i njëjti nuk është vërejtur apo anëtari i Kuvendit, i Komitetit apo komisionit nuk e ka paraqitur atë, atëherë organi që ka marrë vendim, e anulon të njëjtin dhe vendos rishtas për çështjen konkrete e cila ka qenë objekt i shqyrtimit.
3. Kërkesat e parashtruara nga pala e tretë për largim të anëtarit të Kuvendit, anëtarit të komitetit apo komisionit për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit, duhet të jenë të argumentuara me prova materiale lidhur me çështjen konkrete që është objekt i vendosjes gjatë procedurës së vendim-marrjes.

Gjuhët e përdorura në Kuvend dhe në dokumente

Neni 37

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mbahen në gjuhën shqipe dhe serbe, duke siguruar përkthimin adekuat, sipas nevojës.
2. Shërbimet e përkthimit gjithashtu do të sigurohen edhe në gjuhët tjera minoritare, përveç në shqip dhe serbisht në rast se anëtarët e Kuvendit që flasin ato gjuhë marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit dhe që të njëjtit paraprakisht kanë kërkuar shërbime të tilla.
3. Të gjitha dokumentet zyrtare të Kuvendit shkruhen në gjuhën shqipe dhe serbe, sipas nevojës edhe në gjuhën e komunitetit të cilit i referohet dokumenti.

Sekretaria e Kuvendit

Neni 38

1. Sekretaria e Kuvendit është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e Kuvendit, grupeve të anëtarëve dhe të anëtarëve të Kuvendit.
2. Materiali për mbledhjet e rregullta të Kuvendit, duhet të dërgohet shtatë (7) ditë para mbajtjes së mbledhjes, ndërsa tri (3) ditë përpara për mbledhje të jashtëzakonshme, nëpërmjet formave të komunikimit zyrtar.
3. Punët e sekretarisë i udhëheq shefi i sektorit të Kuvendit të Komunës.

Ndryshimi i rregullores së punës së Kuvendit

Neni 39

1. Kryesuesi, e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe në bazë të nevojës mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, të cilat mendon se janë të nevojshme.
2. Propozimin për ndryshimin e Rregullores mund ta iniciojë çdo grup kuvendar, anëtar i Kuvendit të mbështetur nga së paku e 1/3 e anëtarëve të Kuvendit.
3. Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës e merr Kuvendi, me shumicën e anëtarëve të Kuvendit.

Dispozitat kalimtare

Hyrja e rregullores në fuqi

Neni 40

1. Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushojnë të vlejnë dispozitat e Rregullores paraprake për Punën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12480 e datës 21.11.2008

01. nr. 16-53246
Gjilan, më 13.06.2013



Kuvendi i komunës
[Signature]
Ismail Zeka, Kryesues